



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Kabineti i Ministrit/Kabinet Ministra/Kabinet of the Minister

Nr. 299

Data: 10.05.2024

Ministri i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, duke u bazuar në nenin 93 paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenin 10 të Ligjit Nr.06/L - 113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratën Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, nenin 11 paragrafi 1, nën paragrafi 1.5 të Ligjit Nr. 08/L - 117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, Shtojcën 1 pika 10 të Rregullores (QRK) Nr.14/2023 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive si dhe nenit 24 të Ligjit Nr. 03/L - 233 për Mbrojtjen e Natyrës, nxjerr:

V E N D I M

1. Vihet nën mbrojtje paraprake "Guri i Hoxhës me gryken e lumit Përlepnice", Komuna Ranillug si zonë potenciale për shpallje Vlerë e mbrojtur e natyrës në kategorinë Monument i Natyrës, me sipërfaqe prej 30 ha.
2. Bazuar në nenin 24 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 03/L - 233 për Mbrojtjen e Natyrës, Ministria ka pranuar nga Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës (IKMN) arsyetimin fillestar profesional të kryer nga zyrtarët e IKMN se zona "Guri i Hoxhës me gryken e lumit Përlepnice" Komuna Ranillug shquhet me vlera natyrore, shkencore, gjeologjike, gjeo - morfologjike, arkeologjike, kulturore, biologjike peizazhore, edukativo - arsimore dhe turistike dhe duhet të vendoset në mbrojtje paraprake me qëllim të fillimit zyrtar të procedurës për shpallje të zonës së mbrojtur në kategorinë Monument i Natyrës siç përcaktohet në nenin 8 dhe 14 të Ligjit Nr. 03/L - 233 për Mbrojtjen e Natyrës.
3. Mbrojtja paraprake do të zgjas deri sa zona të shpallet e mbrojtur në kategorinë Monument i Natyrës, siç përcaktohet në nenin 19 deri në nenin 22 të Ligjit Nr. 03/L - 233 për Mbrojtjen e Natyrës por jo më gjatë se dy (2) vite nga dita e nxjerrjes së këtij Vendimi.
4. Gjatë periudhës sa do të zgjasë statusi i Mbrojtjes Paraprake do të zbatohen dispozitat Ligjit Nr. 03/L - 233 për Mbrojtjen e Natyrës dhe Zona do të gëzoj statusin e zonës së mbrojtur.
5. Obligohet Komuna e Ranillugut, Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës dhe Departamenti për Mbrojtjen e Mjedisit dhe Ujërave, që t'i ndërmarrin masat e duhura për

zbatimin e këtij Vendimi konform dispozitave ligjore të parapara në Ligjin Nr. 03/L - 233 për Mbrojtjen e Natyrës si dhe dispozitave ligjore tjera relevante në fuqi.

6. Pjesë përbërëse e këtij Vendimi është Raporti i IKMN si studim fillestar nga pika 2 e këtij Vendimi i cili përmban edhe hartën për "Gurin e Hoxhës me gryken e lumit Përlepnice" Komuna Ranillug i cili do të shërbejë si bazë për hartimin e Propozimit Profesional nga organi kompetent.

7. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.



Liburn Aliu

Ministër i Ministrisë së Mjedisit,
Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës

Vendimi i dërgohet:

- Kabinetit të Ministrit;
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm të MMPHI - së;
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm të MBPZHR - së;
- Agjencisë për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës;
- Departamentit për Mbrojtjen e Mjedisit dhe Ujërave;
- Komunës së Ranillugut.